

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "AGRO ORGANIC INTERNACIONAL" SH.P.K
TIRANË

VENDIM
I ASAMBLESË SË ORTAKËVE
TË SHOQËRISË "AGRO ORGANIC INTERNACIONAL" SHPK.
NR. 1 DATË 19.04.2022

Sot, më datë 19.04.2022, në Selinë e Shoqërisë
"AGRO ORGANIC INTERNACIONAL" SH.P.K.
përkatësisht :

"Rr. "Abdyl Frashëri", Kulla "EGT", kati i 7^{të}, apartamenti nr. 21. Kodi Postar 1001,
Tiranë"

u mbledh Asambleja e Ortakëve të shoqërisë **"AGRO ORGANIC INTERNACIONAL"**
SHPK.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve është thirrur nga Ortaku i Vetëm Z. Gëzim Beqaj, cili
zotëron 100 % të kuotës së kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve u mbledh për të shqyrtuar rendin e ditës të përcaktuar më parë për :

1. Ndryshimin e emrit të shoqërisë dhe emrit tregtar nga :

"AGRO ORGANIC INTERNATIONAL"
në
"Agro Organic International"

2. Regjistrimin e këtij ndryshimi në QKB.
3. Autorizimin e administratorit të shoqërisë Z. Gëzim Beqaj për të kryer regjistrimin e këtij vendimi pranë QKB-së.

Mbledhja e Asamblesë së Ortakëve u mbajt nga Ortaku i Vetëm Z.Gëzim Beqaj.

Në lidhje me pikën e parë të rendit të ditës Ortaku i Vetëm Z. Gëzim Beqaj, argumentoi shkaqet që e detyruan për të ndryshuar emrin e shoqërisë dhe emrin tregtar, shkaqe të cilat po i rendisim më poshtë në mënyrë të përmbledhur :

Problematika në lidhje me ndryshimin e emrit të shoqërisë ka ardhur pasi gjatë hartimit të Aktit të Themelimit dhe Statutit të shoqërisë janë përdorur gabimisht të gjithë shkronjat e


1

emrit me gërma kapitale në vend që me gërma të tilla të shkruheshin vetëm shkronjat e para të fjalëve që përbëjnë emrin e shoqërisë.

Gjithashtu, fjala "INTERNACIONAL" për t'ju përshtatur më mirë marrëdhënieve tregtare në tregun ndërkombëtar do të duhej të ishte zëvendësuar me fjalën "International"

Pasi diskutoi në tërësi rendin e ditës, Asambleja e Ortakëve, konform Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 " Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Pranimin tërësisht të gjithë rendit të ditës së mbledhjes.
2. Ndryshimi i emrit të shoqërisë dhe emrit tregtar. Emri i ri i shoqërisë dhe emri tregtar do të jenë :

"Agro Organic International" SHPK

3. Regjistrimin e këtij ndryshimi në QKB.
4. Autorizimin e administratorit të shoqërisë Z. Gëzim Beqaj për të kryer regjistrimin e këtij vendimi pranë QKB-së.

**PËR ASAMBLENË E ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"AGRO ORGANIC INTERNACIONAL" SH.P.K**

**ORTAKU I VETËM
GËZIM BEQAJ**

